KRONIKË E ZEZË

Vdiq i dyshuari për plagosjen e dyfishtë në Fushë-Kosovë

28 janar 2023, 18:53

Shpërndaje në

Ka vdekur i dyshuari për plagosjen e dy grave në Fushë-Kosovë të shtunën, ka konfirmuar mjeku kujdestar në Qendrën Emergjente në Prishtinë, Ejup Govori. Ai ka thënë për KOHËN se i dyshuari është pranuar në QKUK në gjendje të rëndë, por nuk ka arritur t'u mbijetojë plagëve. Ndërkaq, siç ka njoftuar Policia, dyshohet se ai qe vetëplagosur pas lokalizimit të vendndodhjes nga ana e policisë.

Ai ishte i dyshuar për plagosjen e dy grave, nëné e bijë, të shtunën paradite në Fushë-Kosovë. Që nga momenti i plagosjes, ishte në arrati. Policia ka bërë të ditur se pas lokalizimit të vendndodhjes së tij, i dyshuari i armatosur ka shtënë në drejtim të policëve. Policia ka thënë se i dyshuari besohet të jetë vetëplagosur, por se janë duke u zhvilluar hetimet për zbardhjen e rastit.

"Për rrjedhojë, i dyshuari i armatosur, në përpjekje për t'iu shmangur arrestit policor në rrugën 'Fehmi Lladrovci' në Fushë-Kosovë, ka shtënë me armë zjarri në drejtim të policisë duke rrezikuar drejtpërsëdrejti jetën e policëve si dhe qytetarëve përreth, dhe me këtë rast ka bërë të dëmtoshdoshëm dhe të pashmangshëm ndërmarrjen e të gjitha veprimeve policore në përputhje me autorizimet tyre. Ndërkaq që sulmi ndaj policisë është neutralizuar, i dyshuari në përpjekje e sipër për t'iu shmangur arrestit policor, në rrethana që aktualisht po trajtohen ka marrë plagë nga shkrepja e armës së zjarrit. Aktualisht përkundër që ka baza të forta dyshimi për vetëplagosje, policia bashkëkrisht me autoritetet e tjera relevante ligj zbatuese po heton me përpikëri të gjitha rrethanat që karakterizojnë rastin", thuhet në njoftimin e Policisë.

Policia në fund ka thënë se ka marrë informatën nga QKUK-ja në orën 18:45 për vdekjen e të dyshuarit.

Qendra Emergjente në Prishtinë ka konfirmuar më herët se gratë e plagosura janë në gjendje stabile dhe jashtë rrezikut për jetë.

Aksident në Kamenicë, pesë të lënduar
Vdiq gruaja që u godit nga vetura në Fushë-Kosovë disa ditë më parë
Zhduket një 11-vjeçar në Fushë-Kosovë
Një i lënduar nga aksidenti në rrugën Mitrovicë - Prishtinë
Ferizajasit i merret patentë shoferi për gjashtë muaj, voziti dyfish më shumë sesa është e lejuar
Dy të plagosurat në Fushë-Kosovë: Lëndime serioze, por jashtë rrezikut për jetë
Dy gra plagosen nga një burrë në Fushë-Kosovë

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#PLAGOSJE

TaboOla Feed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek
megadritje.al | Sponsored



Overseas Money Transfer from Albania Might Be Faster Than You…
Overseas Money Transfer | Search Ads | Sponsored

Vdiq gruaja që u godit nga vetura në Fushë-Kosovë disa ditë më parë
Një grua, që ishte goditur nga një veturë në Fushë-Kosovë më 16 janar, vdiq të shtunën në QKUK si pasojë e lëndimeve të marra, ka njoftuar Policia e Kosovës. Këmbësorja kishte …
Kohanet



Do You Speak English? Work a USA Job From Home
Work a Usa Job from Home | Search | Sponsored

TË TJERA

Grabitësi i armatosur vodhi 10,000 euro nga filiali i institucionit financiar në Prizren

Gjenden eshtra njeriu në një pyll në Prishtinë

656 monedha 2-euroshe false u deponuan në një bankë

Policia parandalon kontrabandimin e dy lopëve dhe një viçi nga Maqedonia

BALLINA LAJME ZGJEDHJET 2021 KRONIKË KULTURË MES PËR MES VËSHTRIME SPORT HOROSKOPI PODCAST VIDEO MREKULLIA

KOHA
Marketing Politika e privatësisë Kushtet e përdorimit +383 (0) 38 249 105 info@koha.net
Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Partnerët: Shkabaj

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografinë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë 3Koha Ditore, Kohafjaloo, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeleset e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.